



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republik of Kosovo



Komuna e Gjiçanit
Opština Gnjilane
Municipal Gjiçan
Gilan Belediyesi

DREJTORIA E ARSIMIT

05 Nr. 306/ 2013

Data: 02.04/ 2013

Në bazë të vendimit të Kuvendit të Komunës , 01 Nr.16/24231 të datës 15.03.2013, Drejtoria e Arsimit në Gjiçan shpall :

K O N K U R S **PËR NDARJEN E BURSAVE DHE SHPËRBLIMEVE PËR STUDENTË TË** **KOMUNËS SË GJILANIT**

I. Sipas këtij konkursi ndahen 80 (tetëdhjetë) bursa për studentë të dalluar të Komunës së Gjiçanit, për vitin akademik 2012/2013 :

- a) Pesëdhjetë (50) bursa në vlerë prej 60 €, për studentë e Komunës së Gjiçanit, që studiojnë në Universitetet e Kosovës jashtë Komunës së Gjiçanit,
- b) Tridhjetë (30) bursa në vlerë prej 40 €, për studentë e Komunës së Gjiçanit që studiojnë në Universitetet brenda Komunës së Gjiçanit.

Kriteret e përgjithshme për të fituar bursën :

- Studentët që studiojnë në universitetet publike.....2 pikë,
- Studentët që studiojnë në universitetet private të akredituara dhe licencuara.....1 pikë,
- Shfrytëzues të bursave mund të jenë vetëm studentët me vendbanim të përhershëm në Komunën e Gjiçanit,
- Shfrytëzues të bursës studentore mund të jenë vetëm studentët rregullt,
- Nuk do të ketë më shumë se dy bursa për profile të njëjta,
- Studentët që janë shfrytëzues të bursës universitare apo ndonjë burse tjetër nuk mund të jenë edhe shfrytëzues të kësaj burse,
- Studentët që janë në marrëdhënie të përhershme pune nuk mund të jenë përfitues të bursës

Prioritet kanë drejtimet deficitare.

Kriteret e veçanta për të fituar bursën :

- Nota mesatare 10 poentohet me 10 pikë, nëse nuk e ka mbërri bursën e universitetit, të sillet vërtetimi,
- Nota mesatare 9 poentohet me 9 pikë,
- Nota mesatare 8 poentohet me 8 pikë,
- Nota mesatare 7 poentohet me 7 pikë.

Studentët të cilët janë fëmijë, motër apo vëlla të dëshmorit, rastet sociale (të sillet vërtetimi nga enti për punësim, që nuk kanë të punësuar) do të poentohen me 1 pikë .

Dokumentet e nevojshme për aplikim :

- Certifikata e notave (origjinale),
- Kopja e indeksit me të gjitha provimet e dhëna,
- Certifikata mbi vendbanimin e përhershëm,
- Kopja e letërnjoftimit,
- Vërtetimi se aplikuesi është fëmijë, vëlla, motër e dëshmorit,
- Certifikata mbi gjendjen ekonomike në emër të prindit,
- Vendimi mbi shfrytëzimin e ndihmës sociale për vitin 2012/2013,
- Vërtetimi se studenti/ja ka regjistruar vitin akademik 2012/2013 (i rregullt).

Vërejtje : bursat do të ndahen vetëm për studentë që kanë mbaruar një vit e më shumë të studimeve.

Bursat ndahen për afatin kohor : 01.09.2012 deri më 30.06.2013 (për dhjetë muaj).

II. Po ashtu, sipas këtij konkursi ndahen 20 shpërblime për studentë të dalluar të Komunës së Gjilanit, në vlerë prej 200€ në bazë të kriterëve si vijon :

- a. Përfshirja e të gjitha profileve, nga secili profil nga një student,
- b. Përfitues do të jenë ata studentë me mesataren më të lartë në konkurrencë brenda një profili,
- c. Te studentët e një profili me kushte të barabarta do të merret për bazë mesatarja më e lartë e notave profesionale.

Konkursi mbetet i hapur për aplikim 15 ditë nga dita e shpalljes në gazeta zyrtare dhe në mjetet e tjera të informimit publik.

Të gjithë kandidatët e interesuar duhet t'i marrin aplikacionet dhe të plotësuara të dorëzohen pranë Qendrës për Shërbim të Qytetarëve në Gjilan.

Drejtori

Bujar Nevzati